



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 35 (827940)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 5 shtator 2025



Ministri Vengu:
Shpërblime prej 1 deri në
3 paga mujore për
punonjësit e luftës kundër
xjarreve, si vlerësim i
misionit të tyre fisnik



MBROJTJA CIVILE SHQIPTARE: HISTORIA,
SFIDA DHE ANGAZHIMI PËR SIGURINË
E QYTETARËVE NË KOHË KRIZE

Intervistë me Komandantin e Bazës së Mbështetjes për
Emergjencat Civile (BMEC), Kolonel Hajdar Gurra

INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve



faqe 6



NJË GRUA, NJË BOTË: SHENJTËRIMI I
NËNË TEREZËS

Të jesh grua si Nënë Tereza nuk është thjesht një fat
i shkruar në qiell, por një mision i lindur prej zemrës
dhe i vulosur nga vepra. Më 4 shtator 2016, kur
kambanat e Shën Pjetrit...



faqe 9



NGA KUAJT NË TEKNOLOGJINË
E NATO-S – 98 VJET EVOLUCION I
TRANSPORTIT USHTARAK

1 shtator 1927 – Kur transporti ushtarak shqiptar
vuri themelet e një ushtrie moderne.
98 vjet nga themelimi i Shërbimit...



faqe 10



Ministri Vengu: Reformimi i Forcës Tokësore, një domosdoshmëri për Modernizimin dhe Sigurinë e Shqipërisë

Në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore, në Zall-Herr, u zhvillua një ceremoni e veçantë për të përkujtuar krijimin e kësaj strukture të rëndësishme të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Të pranishëm në aktivitet ishin: ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, drejtues të lartë ushtarakë, përfaqësues të trupës dhe personelit civil të FA-së.

Në fjalën e tij, ministri Vengu theksoi rëndësinë historike të themelimit të Komandës së Forcës Tokësore, duke e cilësuar atë një akt të domosdoshëm për ringritjen e ushtrisë shqiptare dhe konsolidimin e shtetit pas periudhave të vështira.

“Ristrukturimi i Forcës Tokësore nuk ishte një akt formal. Ishte një njsje nga e para, një domosdoshmëri pa të cilën Shqipëria nuk do të ishte sot ajo që është. Uniforma nuk është vetëm një shenjë dalluese, por një mburojë për vendin dhe një shërbim i përditshëm ndaj shoqërisë”, – u shpreh ministri Vengu, duke nënvizuar rëndësinë e modernizimit të FA-ve dhe investimeve në infrastrukturë e kapital njerëzor.

Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, komandant i Forcës Tokësore, në fjalën e tij vlerësoi përkushtimin e çdo efektiv si burimin kryesor të forcës së kësaj strukture:

“Ky jubile është dëshmi konkrete e rrugëtimit institucional të FA-së në ndërtimin e kapaciteteve elitare dhe konsolidimin e një force të përgatitur për të përmbushur misionin dhe detyrat brenda e jashtë vendit. Por mbi të gjitha, forca jonë jeni ju, çdo ushtar, çdo oficer, çdo familje që mbështet sakrificën tonë”. Ceremoninë e përshëndeti gjithashtu gjeneralmajor në rezervë, Nazmi Cahani, ish-komandant i Forcës Tokësore, i cili shprehu krenari dhe mirënjohje për përkushtimin dhe sukseset e ushtarakëve ndër vite.

Në përfundim të aktivitetit, të pranishmit patën mundësi të njiheshin nga afër me një pjesë të mjeteve, pajisjeve dhe armatimeve moderne në përdorim nga Forca Tokësore, duke reflektuar standardin e lartë të gatishmërisë dhe profesionalizmit të saj.



Forcat e Armatosura të Emirateve të Bashkuara Arabe përmbyllin misionin 3-javor kundër zjarreve në Shqipëri

Pas një angazhimi intensiv 3-javor, trupa nga Emiratet e Bashkuara Arabe përfundoi me sukses misionin e saj në Shqipëri për mbështetjen e forcave vendase në përballimin e situatave emergjente të zjarreve. Gjatë këtij misioni, 72 efektivë dhe dy helikopterë të tipit “Black Hawk” kryen dhjetëra operacione nga ajri dhe toka, duke asistuar në shuarjen dhe izolimin e vatrave të zjarrit në zona të ndryshme të vendit. Në ceremoninë e përcjelljes së kontingjentit, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, shprehu



mirënjohjen e qeverisë shqiptare për këtë kontribut të çmuar, duke vlerësuar lart profesionalizmin, solidaritetin dhe bashkëpunimin e ngushtë mes dy vendeve. “Ky angazhim i Emirateve të Bashkuara Arabe është dëshmi e një miqësie dhe partneriteti që shkon përtej fjalëve. Faleminderit për ndihmën në mbrojtjen e jetës së qytetarëve

dhe natyrës sonë”, – u shpreh ministri Vengu në fjalën e tij. Misioni i përbashkët shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, duke dëshmuar vullnetin për bashkëpunim në situata emergjente dhe përballjen me sfida të përbashkëta.



Ministri Vengu: Shpërblime prej 1 deri në 3 paga mujore për punonjësit e luftës kundër zjarreve, si vlerësim i misionit të tyre fisnik

Këshilli i Ministrave miratoi një vendim të ri për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në luftën kundër zjarreve në vend. Sipas këtij vendimi, punonjësit e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, si dhe shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri në bashki, do të shpërblehen me nga 1 deri në 3 paga mujore në varësi të angazhimit dhe rolit të tyre në situata emergjente.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, duke shprehur vlerësimin për kontributin e punonjësve të këtij sektori, tha se ky vendim është një vlerësim i merituar për misionin fisnik dhe përpjekjet e shumta të këtij personeli, të cilët shpeshherë veprojnë me vetëmohim në luftën e pabarabartë kundër flakëve.

“Ky vendim është një shenjë e qartë e vlerësimit tonë për punën e palodhur dhe sakrificat e punonjësve të sektorit të mbrojtjes nga zjarri. Ata janë heronj të paepur në situata kritike dhe ky shpërblim është një motivim i rëndësishëm për ta”, - tha ministri Vengu.

Vendimi i ri synon të forcojë motivimin dhe luftën kundër zjarreve, duke përforcuar rolin e kësaj strukture në mbrojtje të jetëve dhe pasurive të qytetarëve shqiptarë.



SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji: Rëndësia e zhvillimit profesional dhe unitetit në radhët e FA, kusht i domosdoshëm për sigurimin e suksesit të përbashkët

Në një takim bashkëbisedues me oficerët e rinj të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji theksoi rëndësinë e vazhdueshme të aftësitë profesionale, disiplinës, integritetit dhe besimit tek vlerat ushtarake dhe kombëtare. Ai vlerësoi se këto janë elementët thelbësorë për shërbimin ndaj atdheut dhe për sigurimin e suksesit të përbashkët.

Në fjalën e tij, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm u ndal edhe te rëndësia e unitetit, bashkëpunimit dhe besnikërisë ndaj detyrës dhe misionit. Ai u shpreh i bindur se vetëm përmes këtyre vlerave mund të arrihen rezultate të shkëlqyera dhe të ndihmohet zhvillimi i karrierës së oficerëve të rinj.

Gjatë takimit, gjenerallejtënant Kingji uroi oficerët për karrierën e tyre dhe u shpreh se suksesi i forcave të armatosura varet kryesisht nga angazhimi, përkushtimi dhe profesionalizmi i çdo ushtari. Ai u rikujtoi oficerëve se profesioni ushtarak është një nga më fisnikët dhe kërkon përkushtim të vazhdueshëm për të



mbrojtur dhe shërbyer me dinjitet atdheut.

Në fund, shefi i Shtabit të Përgjithshëm u shpreh i bindur se të rinjtë oficerë do të vazhdojnë të luajnë një rol kyç në forcimin e kapaciteteve ushtarake dhe në ruajtjen e paqes dhe sigurisë së vendit. Ai u uroi atyre suksese të mëtejshme dhe një karrierë të ndritur në shërbimin e vendit.



BMEC shënon 38-vjetorin e krijimit, ministri Vengu vlerëson kontributin e saj në mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve shqiptarë

Baza e Mbështetjes për Emergjencat Civile (BMEC) shënoi më 1 shtator të vitit 2025, 38-vjetorin e krijimit të saj në një ceremoni të veçantë, ku morën pjesë përfaqësues të lartë të politikës ushtarake dhe efektivë të kësaj strukture të Forcave të Armatosura.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, vlerësoi kontributin e jashtëzakonshëm të BMEC në shërbim të sigurisë dhe mbrojtjes së qytetarëve shqiptarë.

Ministri Vengu theksoi se, gjatë këtyre dekadave BMEC ka qenë gjithmonë në vijën e parë të përballjes me fatkeqësitë natyrore dhe situatat emergjente, duke treguar gatishmëri dhe vendosmëri pa kushte. “Sot shënojmë 38 vite mision dhe besnikëri ndaj Shqipërisë. Ju keni treguar se misioni juaj nuk ka sezon. Në dimër e në verë, ditën e natën, BMEC është gjithmonë aty: për të shpëtuar jetë, për të mbrojtur pasuri, për të garantuar siguri”, - tha ministri Vengu.

Ai nënvizoi rolin e rëndësishëm të kësaj force në reagimin ndaj emergjencave, duke theksuar se ajo është një forcë që nuk dorëzohet, nuk heziton dhe nuk tërhiqet.

Gjithashtu, ministri theksoi rëndësinë e trajnimit të skuadrave vendore për të siguruar një reagim më të shpejtë në çdo cep të vendit.

“Ju nuk jeni vetëm një forcë e gatshme, ju jeni edhe shumëzues force për gjithë vendin. Sot BMEC është më e fortë, më e trajnuar dhe më e pajisur se kurrë. Investimet që kemi bërë janë garanci që forca juaj do të rritet çdo vit. Por mbi të gjitha, është karakteri dhe disiplina juaj që e bëjnë



këtë bazë të pathyeshme”, - përfundoi ministri Vengu.

Në aktivitet ishin të pranishëm gjeneralë, oficerë, nënoficerë dhe punonjës të BMEC, të cilët u falënderuan për kontributin e tyre të përditshëm në mbrojtje të jetës dhe sigurisë së qytetarëve shqiptarë.



Efektivët e Kontingjentit XVII EOD, pjesë e stërvitjes ndërkombëtare “Exercise OAK Resolve”, janë duke ofruar mbështetje të rëndësishme për Brigadën Shumëkombëshe Letoneze.

Detyrat kryesore përfshijnë asgjësimin e mjeteve të pashpërthyer (UXO) dhe hapjen e rrugëve për të mundësuar lëvizshmërinë e trupave gjatë zhvillimit të stërvitjes.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet rrit ndërveprueshmërinë me forcat aleate dhe forcon kapacitetet operacionale të njësive tona në mjedise ndërkombëtare.



Efektivët e Kontingjentit XVII EOD në stërvitjen ndërkombëtare “Exercise OAK Resolve”, për forcimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

25 VITE FORCË TOKËSORE



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Zoti komandant, më 1 shtator 1987, u themelua zyrtarisht Mbrojtja Civile pranë Forcave të Armatosura. Si lindi kjo strukturë dhe çfarë domethënie kishte në atë kohë?

Kjo strukturë ushtarake u krijua si përgjigje ndaj nevojës për mbrojtjen e qytetarëve nga fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu dhe natyra. Fillimisht, funksioni kryesor i saj ishte reagimi i shpejtë ndaj këtyre situatave emergjente, duke ofruar ndihmë të menjëhershme për popullsinë e dëmtuar gjatë fatkeqësive natyrore. Krijimi i saj erdhi si një domosdoshmëri për të siguruar mbrojtje dhe ndihmë në situata kritike.

Cilat ishin prioritetet dhe detyrat kryesore në fillimet e saj?

Si një strukturë e re ushtarake, trupat e Mbrojtjes Civile u organizuan në bazë të një strukture regjimenti rajonal. Ata ishin nën varësi të Ministrit të Mbrojtjes dhe kishin të drejtën e përdorimit të tyre nga Këshilli i Ministrave.

Prioritetet dhe detyrat kryesore të këtij regjimenti, të quajtur Regjimenti i Mbrojtjes Civile Rajonale, përfshinin:

- Përballimin e fatkeqësive natyrore gjatë kohës së paqes, duke ofruar ndihmë të menjëhershme popullatës civile.
- Në situata lufte, eliminimin e pasojave në zonat e dëmtuara, kryesisht në qytetin e Tiranës, dhe nëse situata e kërkonte, në qytete të tjera.

Si ka evoluar Mbrojtja Civile gjatë këtyre 38 viteve?

Evolucioni i Mbrojtjes Civile gjatë 38 vjetëve ka kaluar në shumë etapa të rëndësishme dhe sfiduese. Disa nga pikat kryesore përfshijnë:

- Ndryshimet në konceptet mbi Mbrojtjen Civile, duke reflektuar zhvillimet dhe kërkesat e kohës.
- Përshtatja pas ndryshimeve politike dhe ndryshimit të regjimit totalitar në vend.
- Përshtatja e kuadrit ligjor me standardet e vendeve perëndimore, në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut.
- Rëndësia e shtuar si forcë reaguese operacionale për përballimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.

Vitet '90 sollën sfida të mëdha për gjithë shtetin shqiptar. Si u përball Mbrojtja Civile me ato ndryshime?

Si të gjitha strukturat ushtarake thelbësore dhe kritike për Mbrojtjen Civile, edhe ajo ka pësuar përshtatje të vazhdueshme në përputhje me ndryshimet e mëdha që ka përjetuar ushtria shqiptare. Këto përshtatje strukturore kanë përballuar sfida të mëdha, të cilat kërkojnë: Studim rrënjësor për të siguruar që fleksibiliteti i organizimit të jetë sa më efikas në realizimin e prioriteteve, misioneve dhe detyrave për përballimin e fatkeqësive natyrore.

Një sfidë e veçantë për Mbrojtjen Civile është personeli, ku hasen vështirësi të ndryshme, si: rekrutim i duhur. Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i aftësive pas trajnimeve, për shkak të ndryshimeve teknologjike dhe modernizimit të pajisjeve të specializuara.

Gjithashtu, një sfidë tjetër kryesore është sigurimi i kapaciteteve operacionale, për të rritur: operacionalitetin e njërive, forcën reaguese, efektivitetin në përballimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile në kohë

Cilat kanë qenë momentet më të vështira në rrugëtimin e deritanishëm?

Në këtë rrugëtim plot sfida, ka pasur edhe momente të vështira, ndër të cilat vlen të theksohet viti i mbrapsht '97, ku u shkatërrua pothuajse e gjithë infrastruktura ushtarake, pajisje speciale, mjete, etj. Ka qenë një ndër momentet më të vështira për MCR, pasi u fillua të ngrihej nga asgjëja.

Aderimi në NATO i Forcave të Armatosura dhe rrugëtimi pas viteve 2000 ka qenë një moment i vështirë dhe shumë i rëndësishëm, ku u desh një punë jashtëzakonisht kolosale për rindërtimin e kuadrit ligjor, futjen e koncepteve të reja operacionale, si dhe trajnimin e personelit për të qenë në të njëjtin nivel me vendet partnere.

Një moment i vështirë ndër vite ka qenë mungesa e motivimit

Mbrojtja Civile Shqiptare: Historia, Sfida dhe Angazhimi për Sigurinë e Qytetarëve në Kohë Krize

Intervistë me Komandantin e Bazës së Mbështetjes për Emergjencat Civile (BMEC), Kolonel Hajdar Gurra



si rezultat i pajisjeve të dobëta dhe rrogave shumë të ulëta, por që me kalimin e viteve dhe ndryshimeve të koncepteve mbi përballimit të EC-ve ka ndryshuar për mirë në këtë drejtim.

Së fundmi ja vlen të shtojmë se në konceptin e trupave të BMEC-së, momente të vështira janë të gjitha momentet ku mundësia për të ndihmuar popullsinë civile i kalon kufijtë e reales.

Po arritjet më të rëndësishme, cilat do të veçonit?

Për forcat e Mbrojtjes civile çdo lloj arritje veçohet tek arritjet e rëndësishme, për shkak të ndjeshmërisë dhe të ndihmës reale dhe efiente që jepet e ndjehet në komunitet në rastet me kritike të tyre, gjatë zhvillimit të operacioneve të emergjencave civile në ndihmë të përballimit të fatkeqësive natyrore. Por ja vlen ta përmendim që ndër arritjet që na bëjnë krenar është zhvillimi i operacioneve të EC edhe jashtë kufijve, ku deri tani kemi zhvilluar operacione për shuarje zjarri në Republikën e Greqisë si dhe operacion kërkim-shpëtimi në përballimin e fatkeqësisë natyrore të tërmetit në Republikën e Turqisë.

Si është e organizuar sot Mbrojtja Civile dhe cilat janë komponentët kryesorë të saj?

Baza e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile e organizuar dhe strukturuar në një strukturë të mirëfilltë ushtarake, për një reagim të shpejtë në përballimin e të gjitha fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu. Nënrepartet më të rëndësishme të BMEC-së janë katër kompanitë operacionale dhe detashmenti Mengel, Elbasan, me shtrirje në Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe mbulim të të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë. Këto nënreparte kanë detyra specifike të ndara nga njëra-tjera, ku përgjigjen për përballimin e fatkeqësive të shkaktuara nga zjarri, përmbytjet, tërmetet. Baza e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile ka në përbërje nënrepartin e shtabit, qendrën stërvitore për emergjencat civile, kompaninë mbështetëse, ku përpunohet dhe hartohet kuadri ligjor, koordinohen veprimtaritë për operacionet ushtarake, realizohet kryerja e mbështetjes së nënreparteve operacionale për përmbushjen e detyrave dhe kryerjen e operacioneve të EC-ve me sukses.

Në ç'mënyrë bashkëpunon kjo strukturë me institucionet



e tjera të vendit?

Struktura jonë ka një bashkëpunim pothuajse perfekt me institucionet e tjera të vendit. Aktivizimi i BMEC-së në operacione për përballimin e EC-ve, operacioneve të kërkim-shpëtimit, realizohet nëpërmjet zinxhirit të komandimit që fillon nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. Bashkëpunim shumë të mirë kemi me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, qoftë institucional ashtu edhe të forcave në terren. Kemi një bashkëpunim korrekt nëpërmjet planeve të bashkëpunimit me seksionet EC-ve me prefekturat e bashkitë e vendit.

Sa i rëndësishëm është bashkëpunimi ndërkombëtar dhe integrimi me standardet e NATO-s dhe BE-së?

Me sfida të reja, kushtëzuar nga globalizmi, një bashkëpunim përtej kufijve, me partnerët dhe aleatët tanë është sa i rëndësishëm aq edhe kritik, gjë e cila bën të mundur përmbushjen e një sërë sfidash në drejtim të profesionalizmit dhe ekspertizës për të reaguar në mënyrë efektive, mbi parandalimin, reduktimin dhe

zvogëlimin e risqeve në operacionet për përballimin e EC-ve dhe të kërkim-shpëtimit. Përafrimi dhe qasja me standardet e NATO-s dhe BE-së është një domosdoshmëri për BMEC-në. Me ndihmën e Shtabit të Përgjithshëm, Komandës Mbështetëse dhe AKMC-së, jemi futur në një rrugë ku programet e bashkëpunimit, trajnimit si dhe standardizimit të procedurave me vendet e NATO-s, BE-së dhe të rajonit, është bërë obligacion nga ana jonë.

Çfarë roli kanë qytetarët dhe shoqëria civile në sistemin e mbrojtjes civile?

Qytetarët dhe shoqëria civile kanë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në sistemin e Mbrojtjes Civile, duke filluar që me sensibilizimin fillestar, detyrimin që kanë për të informuar lidhur me të dhënat që ndihmojnë institucionet publike dhe strukturat e mbrojtjes civile në përballimin e gjendjes së fatkeqësisë. Përfshirja në detyra të veçanta, në përputhje me përgatitjen, aftësitë dhe me nevojën për të ndihmuar në kapërcimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore civile dhe deri tek mbështetja direkte në operacionet

e përballimit të emergjencave civile, duke pasur detyrimin për zbatimin e urdhrave, të masave dhe të udhëzimeve për ndjekjen e procedurave të kërkuara, në mënyrë të veçantë për evakuimin e detyruar.

Si është gjendja e kapaciteteve teknike dhe njerëzore sot?

Baza e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile zotëron kapacitete teknike bashkëkohore dhe moderne që qëndrojnë në të njëjtin nivel me vendet partnere të NATO-s dhe BE-së. Po bëhet një punë e jashtëzakonshme për mbështetje dhe kompletim të plotë me mjete, pajisje e infrastrukturë nga Autoritetet Civile, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, Komanda Mbështetëse, duke krijuar një strukturë bashkëkohore në përballimin në mënyrë profesionale e efikase të fatkeqësive natyrore. Për sa i përket kapaciteteve njerëzore kemi nevojë për kompletim, ku në planet afatshkurtra është më se i realizueshëm. Kapacitetet njerëzore aktuale janë të motivuar, të mirë trajnuar edhe pse tek ne trajnimi dhe stërvitjet janë një proces i vazhdueshëm brenda vendit ashtu edhe me partnerët ndërkombëtar. Aktualisht kemi trupa për trajnim e stërvitje në Kosovë e Bullgari.

Çfarë synimesh dhe vizioni keni për të ardhmen e Mbrojtjes Civile?

Synimet dhe vizioni për BMEC-në shkon në drejtim të profesionalizimit, aftësimin dhe trajnimit të kapaciteteve njerëzore sipas doktrinae të vendeve të NATO-s dhe BE-së në mënyrë që të krijojmë një trupë operacionale e aftë të operojë brenda dhe jashtë vendit në përballimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile. Rinovimi i teknikës, pajisjeve, në mënyrë periodike dhe në koherencë me zhvillimet teknologjike është një synim dhe vizion që për ne është një kusht që duhet realizuar. Ndryshimet strukturore të mundshme për përafrimin e strukturës aktuale me strukturat homologe të vendeve partnere, në mënyrë që të rrisim nivelin e bashkëpunimit dhe operimit të ndërsjellë me vendet e NATO-s, BE-së dhe atyre të rajonit ngelet një synim dhe sfidë për BMEC-në. Motivimi i kapaciteteve njerëzore si nga ana financiare por edhe nxitja e mbështetja e vetëzhvillimit të tyre personal ngelet një synim për t'u realizuar, duke siguruar gjetjen e burimeve mbështetëse.

Cili është mesazhi juaj për qytetarët shqiptarë në këtë 38-vjetor të krijimit të Mbrojtjes Civile?

Mesazhi im që shkon për qytetarët është të reagojnë sa më shpejt në njoftimin e autoriteteve të mbrojtjes civile mbi ekzistencën e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile si dhe të kenë besimin e plotë se ne do të jemi aty në përballimin e këtyre Emergjencave Civile si dhe lehtësimin e shkallës së dëmtimit të të prekurve ndaj këtyre fatkeqësive.

“

MBROJTJA CIVILE U KRIJUA SI PËRGJIGJE NDAJ NEVOJËS PËR MBROJTJEN E QYTETARËVE NGA FATKEQËSITË E SHKAKTUARA NGA NJERIU DHE NATYRA. FILLIMISHT, FUNKSIONI KRYESOR I SAJ ISHTE REAGIMI I SHPEJTË NDAJ KËTYRE SITUATAVE EMERGJENTE, DUKE OFRUAR NDIHMË TË MENJËHERSHME PËR POPULLSINË E DËMTUAR GJATË FATKEQËSIVE NATYRORE.

“

PËR FORCAT E MBROJTJES CIVILE ÇDO LLOJ ARRITJE VEÇOHET TEK ARRITJET E RËNDËSISHME, PËR SHKAK TË NDJESHMËRISË DHE TË NDIHMËS REALE DHE EFICENTE QË JEPET E NDJEHET NË KOMUNITET NË RASTET ME KRITIKE TË TYRE, GJATË ZHVILLIMIT TË OPERACIONEVE TË EMERGJENCAVE CIVILE NË NDIHMË TË PËRBALLIMIT TË FATKEQËSIVE NATYRORE.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Shpërqendrimi si shenjë e kohës sonë

Nuk është rastësi që sot shumë prej nesh ndihen si “aeroplan pa aerodrom”, duam të kontrollojmë orën në telefon dhe papritur gjendemi duke lexuar një artikull që nuk ka lidhje me jetën tonë, dalim për të blerë bukë dhe kthehemi pa bukë, por me duar plot gjëra të panevojshme. Ky fenomen nuk është individual, por kolektiv. Shpërqendrimi është bërë norma e epokës sonë.

Në një botë ku informacioni qarkullon me shpejtësi marramendëse dhe ekranet ndriçojnë çdo cep të ditës sonë, vëmendja është kthyer në një burim të rrallë, në një luks të vërtetë. Dhe si çdo luks, ajo duhet kërkuar, kultivuar dhe mbrojtur.

Nga “fokusi” i fëmijërisë tek “fokusi” si shpëtim

Në kujtesën e shumë prej nesh, fjala fokus lidhet me kërkesën e mësuesit për disiplinë: “Mos u shpërqendro!”, “Mbah mendjen këtu!”. Ishte një urdhër për të qenë të rregullt, për të ndjekur një vijë lineare. Por sot kuptimi i fokusit është transformuar.

Nuk është më thjesht detyrim, por nevojë ekzistenciale. Jo kërkesë për të bërë më shumë, por mundësi për të ndier më thellë. Fokus nuk do të thotë vetëm të përmbushësh detyrat, por të krijosh hapësirë për kuptim, në një bisedë të zakonshme, në një mëngjes të thjeshtë, në një ide që merr formë.

Kur vëmendja bëhet akt dashurie

Një episod i thjeshtë e tregon këtë më së miri: një nënë që i kërkon së bijës një “shikim” për diçka që ka blerë me qejf. Nuk kërkon miratim formal, por praninë e plotë, një po që lind nga vëmendja. Ky moment tregon se fokus nuk është luks vetëm për veten, por edhe një gjest dashurie ndaj tjetrit.

Të japësh vëmendjen tënde është një dhuratë më e vlefshme sesa çdo send material.

Shkenca e fokusit dhe shpërqendrimit

Psikologjia moderne flet për “ekonominë e vëmendjes”. Çdo njoftim, çdo reklamë, çdo zë i botës digjitale konkurron për disa sekonda të trurit tonë. Studimet tregojnë se një njeri i zakonshëm ndërpritet mbi 150 herë në ditë nga telefonata, mesazhe apo sinjalizime. Për t’u rikthyer tek një detyrë, trurit i duhen mesatarisht 23 minuta.

Në këtë kuptim, shpërqendrimi nuk është thjesht bezdi, por kosto reale: kosto produktiviteti, kosto emocionale, kosto marrëdhëniesh. Dhe vetëm përmes fokusit mund të rivendosim balancën.

Dimensioni shoqëror: nga konsumatori tek qytetari

Shpërqendrimi është gjithashtu një mjet pushteti. Sa më i shpërqendruar të jesh, aq më lehtë shndërrohesh në konsumator pasiv, blen pa menduar, klikon pa reflektuar, voton pa analizuar. Në këtë sens, të mësosh të fokusohesh nuk është vetëm akt personal, por edhe politik. Është mënyrë për të mos u lënë peng i sistemeve që ushqehen nga hutimi ynë.

Fokusi si zgjedhje për të jetuar me vetëdije

Ndoshta nuk kemi nevojë të bëjmë më shumë, por të qëndrojmë aty ku jemi edhe kur bota na shtyn të jemi gjithmonë diku tjetër në një rrjet social, në një punë paralele, në një pritshmëri të huaj, të zgjedhësh fokusin është të rikthehesh tek vetja.

Shtatori, me ritmin e tij të ngadalshëm e të butë, është një ftesë e heshtur, ku po e çoj energjinë time? Kujt ia jap orët më të mira të ditës? Dhe mbi të gjitha, a po i jap vetes mundësinë të ndiej thellë çfarë po bëj dhe kur duan të më pengojnë të bëj punën dhe pasionin tim?

Fokusi si shpëtim

Çfarëdo që të kërkojmë, qetësi, kuptim, lidhje apo krijimtari e gjejmë vetëm kur ndalemi dhe fokusohemi. Fokus është mënyra më e thjeshtë dhe më e fuqishme për të qenë njerëzorë në një botë që na shtyn të jemi gjithnjë të shpërndarë.

Le të reflektojmë dhe të zgjedhim të jetojmë më pak të hutuar dhe më shumë të vetëdijshëm. Jo si detyrim, por si dhuratë që ia bëjmë vetes dhe të tjerëve.

Është më e lehtë të humbasësh sesa të mbetesh, është më e lehtë të lundrosh nga një dritare sociale tek një tjetër sesa të ulesh me mendimet e tua. Por pa fokus, energjia jonë shpërndahet në copëza të vogla, dhe asgjë nuk merr formë të plotë. Pa fokus, jeta rrezikon të bëhet një reagim i pafund ndaj të tjerëve, jo një krijim i vetëdijshëm nga ne.

Të zgjedhësh fokusin do të thotë të thuash “jo” ndaj zhurmës përreth, të krijosh kufij, dhe të ushqesh atë që të rrit, edhe nëse kjo do të thotë të zhgënjesh pritshmëritë e botës.




Është një akt i heshtur guximi të jesh aty ku je, jo aty ku të tjerët duan që të jesh. Sepse vetëm kur jemi të përqendruar, ne kemi fuqinë të jetojmë me vetëdije, të ndërtojmë me qëllim, dhe të krijojmë një jetë që nuk është pasqyrë e të tjerëve, por shprehje e plotë e vetes sonë. Fokus nuk është thjesht një ushtrim i mendjes për t’u përqendruar në një detyrë, është një mënyrë jetese që na rikthen tek vetja.

Të jesh i fokusuar do të thotë të kuptosh se ku e drejton vëmendjen tënde, sepse aty shkon edhe energjia jote. Nëse shpërndahemi në çdo thirrje të jashtme, humbasim qartësinë e brendshme dhe nuk arrijmë të ndërtojmë qëndrueshmëri.

Megjithatë, mbajtja e fokusit nuk është e lehtë. Të tretët

shpesh ndikojnë mbi ne, pritshmëritë e familjes, presioni i mjedisit të punës, apo normat e shoqërisë mund të na largojnë nga drejtimi ynë i dëshiruar. Pikërisht këtu qëndron forca e vërtetë e fokusit: të thuash “jo” ndaj zhurmës së jashtme dhe të thuash “po” ndaj vetes. Ky akt është një formë guximi, sepse na kërkon të përballojmë zhgënjimin e të tjerëve për të mos braktisur qartësinë tonë të brendshme.

Fokusi nuk të izoloj nga bota, përkundrazi, të ndihmon të marrësh pjesë në të me qartësi, me energji të mbledhur dhe me një drejtim të vetëdijshëm. Në një kohë ku shpërqendrimi sundon, fokusi mbetet një nga aktet më të thjeshta, por edhe më të fuqishme të lirisë personale.



NJË GRUA, NJË BOTË

SHENJTËRIMI I NËNË TEREZËS

Shefe e Sektorit të Botimeve,
Anjeza Musollari

Të jesh grua si Nënë Tereza nuk është thjesht një fat i shkruar në qiell, por një mision i lindur prej zemrës dhe i vulosur nga vepra. Më 4 shtator 2016, kur kambanat e Shën Pjetrit kumbuan për shenjtërimin e saj, bota u ndal për një çast dhe pa tek një grua e vogël nga Shkupi një dritë që e kishte ndriçuar njerëzimin për dekada me radhë. Ishte dita kur një jetë e përulur, e përkushtuar dhe e konsumuar për të varfrit, u njoh zyrtarisht si shenjtëri. Por për miliona njerëz, ajo kishte qenë shenjtoresh shumë përpara kësaj dite.

Shumëkush e përshkruan atë si “nënë të të varfërve”, por në të vërtetë ajo ishte një nënë universale. Një grua që shihte fëmijën e saj tek çdo jetim, tek çdo i sëmurë, tek çdo trup i braktisur në rrugët e Kalkutës. Ajo nuk e njihte dallimin mes racës, fesë apo kombësisë, sepse për të njeriu ishte gjithmonë pasqyrë e Zotit.

Në atë ditë të shenjtërimin, sheshi i Shën Pjetrit ishte mbushur me fytyra të pafundme. Dikush nga Filipinet mbante një lule në dorë, dikush nga Italia një fotografi të vjetër të saj, një shqiptare e moshuar nga Kosova lotonte në heshtje, ndërsa një vajzë e vogël indiane mbante në duar një qese me oriz, simbol i thjeshtësisë së saj. Ky mozaik njerëzish ishte dëshmia më e gjallë se vepra e Nënë Terezës kishte kaluar kufijtë dhe kishte mbërritur në çdo zemër.

Por ajo ditë ishte edhe një pasqyrë për ne shqiptarët. Në një botë ku shpesh mburremi me figura politike e historike, ishte një grua e thjeshtë, e përulur dhe pa pushtet tokësor, ajo që na dha emrin më të madh në hartën e njerëzimit. Në atë moment, shqiptarët nuk ishin thjesht një komb i vogël ballkanik, ishin kombi i një shenjtoreje. Nënë Tereza u bë një nga urat ndërlidhëse të njohjes së shqiptarëve në botë. Ish-presidenti amerikan Bill Clinton është shprehur në qershor 2002: “Nënë Tereza, Ajo ishte e para që më bëri ta dua kombin shqiptar. Dhe tani ndihem shumë krenarë që plotësova një detyrë morale ndaj saj dhe ndaj vlerave të lirisë”.

Të jesh grua si Nënë Tereza është të kesh kurajën të zgjedhësh rrugën më të vështirë, atë të dashurisë pa kushte. Në një kohë kur bota e mat vlerën e njeriut me pasuri, pushtet dhe famë, ajo dëshmoi të kundërtën, vlera e njeriut matet me aftësinë për të dashur tjetrin. Ajo nuk kishte asgjë materiale për të ofruar, por kishte gjithçka që bota kishte më shumë nevojë,

një zemër që dinte të ndante dhembshuri.

Kur një gazetar i huaj e pyeti dikur: “Çfarë mund të bëjmë për të ndryshuar botën?”, ajo u përgjigj thjesht: “Shkoni në shtëpi dhe dashuron familjen tuaj.” Në këtë përgjigje të shkurtër fshihej filozofia e saj jetësore, ndryshimi i madh fillon me gjestin e vogël, me dashurinë e përditshme, me kujdesin ndaj atyre që kemi pranë.

Në këtë ditë të shenjtërimin, shumë njerëz panë në figurën e saj jo vetëm një murgeshë, por një udhërrëfyesë. Për gratë e reja, ajo është një shembull se feminiteti nuk është i kufizuar në bukurinë apo suksesin social, por në aftësinë për të transformuar realitetin përmes dashurisë. Për burrat, ajo është dëshmi se forca e vërtetë nuk qëndron në dominim, por në shërbim. Për popujt, ajo është mesazh se paqja nuk arrihet me marrëveshje politike, por me zemra që e pranojnë tjetrin.

Nënë Tereza nuk ishte e pasur me tituj e as me pronë. Ajo ishte e pasur me kohë, kohën që ia dha njeriut. Ishte e pasur me sy që shihnin dinjitet aty ku të tjerët shihnin turp. Ishte e pasur me duar që preknin pa frikë plagët, me buzëqeshje që i falte edhe atyre që nuk i jepnin asgjë mbrapsht.

Çdo përvjetor i asaj dite të shenjtërimin është një kujtesë dhe një sfidë. Kujtesë për të mos harruar se edhe në kohët më të errëta, një njeri i vetëm mund të ndezë dritën për miliona të tjerë. Sfidë, sepse është detyrë e secilit prej nesh që ta vazhdojë misionin e saj, në mënyrën tonë të vogël, të vizitojmë një të moshuar të vetmuar, të ndihmojmë një fëmijë në nevojë, të japim një buzëqeshje aty ku ka vetëm heshtje.

Të jesh grua si Nënë Tereza do të thotë të mos lodhesh kurrë së dashuruari, do të thotë të mos kesh frikë nga varfëria e jashtme, sepse e di se pasuria e brendshme është e pashtershme, do të thotë të kesh guximin të jesh e vogël në një botë që vlerëson vetëm madhësinë.

Shenjtërimi i saj ishte një kurorëzim. Por më shumë se aq, ishte një mesazh i përjetshëm se dashuria e sinqertë nuk vdes kurrë.

Ajo grua e vogël, me trup të brishtë dhe shikim të lodhur, na mësoi se madhështia nuk matet me lartësinë e katedraleve, por me gjunjët që përkulen përpara një të varfëri.

Nënë Tereza nuk na la trashëgimi një pasuri materiale, por një trashëgimi shpirtërore që është më e vyer se çdo ar. Dhe në çdo 5 shtator, ajo trashëgimi ringjallet si një ftesë për të zgjedhur edhe ne rrugën e dashurisë.

1 shtator 1927 – Kur transporti ushtarak shqiptar vuri themelet e një ushtrie moderne

98 vjet nga themelimi i Shërbimit të Transportit – Ahmet Zogu: “Pa logjistikë, ushtria është trup pa shpirt”.

Para saktësisht 98 vitesh, më 1 shtator 1927, në një Shqipëri të re pas Luftës së Parë Botërore, u krijua Shërbimi i Transportit të Ushtrisë Shqiptare. Ky hap historik, i iniciuar nga qeveria e Ahmet Zogut, shënoi fillimin e modernizimit të forcave të armatosura dhe vendosjen e themeleve të logjistikës ushtarake.

Sot, në 98-vjetorin e këtij institucioni, “Ushtria” rikujton rolin e tij jetik në mbrojtjen e vendit dhe transformimin nga karroca me kuaj në teknologji të përparuar.

Shqipëria e Vitit 1927: Një Ushtri “Pa Këmbë”

Pas pavarësisë (1912) dhe Luftës Botërore (1914–1918), ushtria shqiptare ishte e fragmentuar, pajisjet e saj të kufizuara dhe transporti ishte pothuajse i munguar. Në vitin 1927, Ahmet Zogu, Kryeministër dhe më vonë Mbret, nisi një reformë të gjerë ushtarake. Si pjesë e saj, Urdhri i Ditës Nr. 123 themeloi Shërbimin e Transportit me mision:

- Të siguronte lëvizjen e trupave, armëve dhe municioneve.
- Të menaxhonte depo ushtarake dhe linja furnizimi.
- Të bashkëpunonte me ministrinë e tjera për transportin civil-ushtarak.

Nga Karrocet me Kuaj në Automjete të Para - Shërbimi filloi me 12 karroca me kuaj, 8 automjete të vjetra (të blera nga Italia) dhe 30 oficerë nën komandën e Kolonel Hysni Toskës.

Paralelisht, u ndërtua Depoja Qendrore e Transportit në Tiranë (pranë kazermës së sotme “Zall-Herr”).

Roli në Luftën e Dytë Botërore dhe pas luftës

Gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939–1944), transporti ushtarak u bë mjet kyç i rezistencës:

1943–1944: Partizanët përdorën karroca me kuaj dhe mushka për të transportuar armë në malet e Shqipërisë së Veriut dhe Jugut.

1944–1950: Nën regjimin komunist, shërbimi u zgjerua me automjete sovjetike (ZIS, GAZ) dhe u riemërua “Batalioni i Transportit”.

Nga Automjetet Sovjetike në Teknologjinë e NATO-s

Pas rënies së komunizmit (1991), Shërbimi i Transportit kaloi transformimin më të madh.

1992–2000: Bashkëpunimi me SHBA-në dhe Gjermaninë solli automjete moderne (Humvee, Mercedes-Benz). 2009–Sot: Anëtarësimi në NATO çoi në standardizimin e pajisjeve dhe integrimin në sistemin logjistik të Aleancës. Sot, shërbimi operon me 150+ automjete taktike (përfshirë “Oshkosh” për transport trupash), 30 helikopterë UH-60 “Black Hawk”.

Logjistika = Forca Luftuese: Siç thoshte gjenerali Dwight D. Eisenhower: “Ushtritë luftojnë me stomak”.
Pa transport, asnjë operacion nuk mund të realizohet.

Adaptimi Ndaj Teknologjisë: Kalimi nga kuajt në dronët e transportit tregon se ushtria duhet të evoluojë me kohën.

Integrimi në NATO tregoi se standardizimi i pajisjeve është jetik për operacionet e përbashkëta.

Nga 12 karrocet në forcën e bashkëpunimit NATO

98 vjet më vonë, Shërbimi i Transportit nuk është vetëm një degë e ushtrisë, por simboli i qëndrueshmërisë dhe adaptimit.

Batalioni i Transportit mbështet me Transport Komandën Mbështetëse dhe Strukturat e FA-së, në kohë paqe, krize dhe lufte, si dhe sigurimin e transportit të personelit dhe ngarkesave në mbështetje të operacioneve të Forcave të Armatosura brenda dhe jashtë vendit.

Misioni i Batalionit të Transportit është komandimi, kontrolli, trajnimi dhe mirëmbajtja e një niveli të lartë



Nga kuajt në teknologjinë e NATO-s – 98 vjet evolucion i Transportit Ushtarak

gatishmërie dhe operacionale, siguron transport të personelit dhe ngarkesave në mbështetje të operacioneve të FA-së, por dhe në ndihmë të komunitetit e në të gjithë spektrin e operacioneve.

Misioni i Batalionit të Transportit realizohet brenda misionit të Komandës të Mbështetjes, i organizuar si një hallkë e rëndësishme e zinxhirit logjistik me pajisjet dhe teknikën e mjeteve të transportit të kohës, në përshtatje me kushtet dhe nivelin teknologjik ku vepron, mbështetur në përvojën më të mirë të shkuar teorike e teknike, kombëtare dhe të vendeve të Aleancës të NATO-s. Batalioni i Transportit ka detyrë të transportojë personelin, pajisjet, kontejnerët dhe ngarkesat në mbështetje të operacioneve të Forcave të Armatosura.

Të sigurojë kapacitete transporti për personelin dhe pajisjet, për një Batalion Këmbësorie njëherësh të Forcës Tokësore.

Ka detyrë të komandojë, kontrollojë, pajisë, trajnojë dhe të mbajë një nivel të lartë të gatishmërisë operacionale për batalionin.

Administron dhe mirëmban infrastrukturën, pajisjet dhe teknikën. Por gjithashtu Batalioni i Transportit ka për detyrë të transportojë, ngarkojë dhe shkarkojë kontejnerë ISO në mbështetje të Operacioneve të Forcave të Armatosura të RSH.

Të transportojë ngarkimin dhe shkarkimin e pajisjeve kontejnerëve dhe ngarkesave në porte detare dhe aeroporte, kur kemi transport ajror. Gjithashtu mbështesin me transport strukturat e Forcave të Armatosura për përballimin e operacioneve të emergjencave, krizave, fatkeqësive natyrore, ndihmave humanitare dhe operacioneve paqeruajtëse. Batalioni i Transportit ka detyrë të sigurojë mbështetjen me transport për të gjitha klasat e furnizimit (5 KI), ai qëndron në pararojë të shërbimit të mbështetjes me transport të FA-së, si reparti më i madh e i specializuar, me përvojë transportuese në fuqi, kapacitet dhe në organizimin operacional transportues ushtarak.

Në rrugëtimin e tij të gjatë batalioni i transportit ka realizuar detyra të ndryshme. Në morinë e detyrave mjaft të rëndësishme

dhe njëherësh me përgjegjësi të lartë për Transportin Ushtarak, ka qenë pjesëmarrja në paradat ushtarake, si ajo e zhvilluar, më datë 04 dhjetor 2017, me rastin e 95-vjetorit të krijimit të FARSH. Batalioni i Transportit u vlerësua me medalje me urdhër nr. 616 dt. 03.12.2017, “Për dhënie medalje të Rep. Ush. Nr. 4007” nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i cili i akordon BTr-së Medalje “Repart i Shquar”, me motivacionin: “Për arritje të shquara për mbështetje në transport në Forcat e Armatosura”.

Gjithashtu ka spikatur edhe në transportimin e personelit, materialeve, të të shpërngulurve gjatë luftës në Kosovë, në vitin 1998-1999.

Kurse në vitin 2007, batalioni ka marrë pjesë në projektin “Projekti për asgjësimin e municioneve të rënda” në bashkëpunim me kompaninë Amerikane SAIC, ku u transportuan dhe asgjësuan rreth 2772 tonë municione dhe u reduktuan rreth 11 grup-depo të strukturave të FA-së, sipas nevojave me miratim të strukturave eprore.

Batalioni i transportit disponon mbi 100 mjete të tipave të ndryshme, të cilat janë të ndara në Kamion të lehtë, të Mesëm, të Rëndë dhe mjete speciale. Këto mjete kryejnë shërbimin për Emergjencë Civile (EC), Transport municioni në interes të ndërmarrjes “MEICO”, Zhvendosje municioni për repartet e Komandës Mbështetëse, Transport materialesh jashtë vendit, Transport materialesh teknike etj. Mbështetja me transport për INSTAT, Mbështetja me transport e të III-ve, Transport skrapit.

Batalioni i Transportit ka kryer dhe kryen detyra në interes të Pushtetit Qendror e Vendor, për transportin dhe shpërndarjen e materialeve logjistike të KQZ-së në të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë. Megjithatë është teknikë e vjetër në vite, ajo ka përballuar me sukses mbështetjen me transport të mesëm e të rëndë të të gjitha strukturave ushtarake të FA-së në stërvitje të ndryshme, duke realizuar me sukses të gjitha detyrat e ngarkuara nga MM, SHPFA, dhe komandanti i KM-së.

Forumi Strategjik i Bledit 2025

Qyteti piktoresk i Bledit në Slloveni u shndërrua në epiqendrën e diplomacisë globale, duke mirëpritur edicionin e 20-të të Forumit Strategjik të Bledit (BSF). Nën moton “Një botë që po shpëton nga kontrolli”, liderë politikë, diplomatë, ekspertë të sigurisë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare u mbledhën për të diskutuar sfidat më urgjente të kohës. Mes tyre, NATO shënoi një prani të rëndësishme, duke riafirmuar rolin e saj si garantues i sigurisë kolektive dhe stabilitetit euroatlantik.

Zëvendëssekretarja e Përgjithshme e NATO-s: Mesazh i Qartë për Ukrainën

Zëvendëssekretarja e Përgjithshme e NATO-s, Radmila Shekerinska, mori pjesë në Forumin Strategjik të Bledit, Slloveni. Në panelin “Ukraina: Rruga e Gjatë drejt Paqes”, ajo pohoi mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s për Ukrainën, ndërsa aleatët punojnë për të siguruar që Ukraina të mund të mbrohet sot dhe të pengojë agresionin e ardhshëm.

Znj. Shekerinska përshkroi mbështetjen thelbësore ushtarake të Aleatëve për Ukrainën, duke përfshirë, deri më tani, mbi dy miliardë dollarë mbështetje përmes Listës së re të Kërkesave me Prioritet për Ukrainën (PURL) të NATO-s: një iniciativë e re që do të sjellë furnizime dhe pajisje kritike amerikane në Ukrainë. NATO gjithashtu punon me, dhe mbështet, Ukrainën përmes masave të tilla si Këshilli NATO-Ukrainë (NUC), Përfaqësimi i NATO-s në Ukrainë (NRU), Ndihma dhe Trajnimi i Sigurisë së NATO-s për Ukrainën (NSATU) dhe Qendra e Përbashkët e Analizës, Trajnimit dhe Edukimit NATO-Ukrainë (JATEC).

Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme përgëzoi përpjekjet e Presidentit Trump për t'i dhënë fund luftës, duke thënë se Aleatët duhet të vazhdojnë mbështetjen e tyre “në mënyrë që Ukraina të mund të negociojë vërtet nga një pozicion force”. Ajo theksoi se garancitë e sigurisë dhe mbrojtja e fortë janë kritike për të siguruar që Rusia të mos e sulmojë më kurrë Ukrainën. Znj. Shekerinska përfundoi se me guximin e Ukrainës, të kombinuar me mbështetjen e Aleatëve, Ukraina do të triumfojë dhe paqja është e mundur.

Roli i Shqipërisë në Forumin Strategjik të Bledit 2025: Një Zë Aktiv për Integrimin dhe Dialogun Rajonal

Në edicionin e 20-të të Forumit Strategjik të Bledit, Shqipëria shënoi një prani të rëndësishme dhe aktive, duke kontribuar në diskutimet strategjike mbi të ardhmen e Ballkanit Perëndimor, sigurinë rajonale dhe integrimin evropian. Përfaqësimi shqiptar u kryesua nga Kryeministri Edi Rama dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, të cilët morën pjesë në panele të nivelit të lartë dhe takime bilaterale me liderë ndërkombëtarë.



Kryeministri Edi Rama: Integrimi si Prioritet Strategjik

Edi Rama ishte i ftuari special në panelin “Shteti, Bashkimi European dhe kampionët e së ardhmes”, ku ndau perspektivën e Shqipërisë për integrimin në BE dhe rolin e saj si faktor stabiliteti në rajon. Ai theksoi se Shqipëria është e gatshme të përmblushtë detyrimet e mbetura dhe se procesi i integritetit nuk duhet të vonohet për arsye politike.

Në panelin “Premtimi i Bledit: Ëndërr apo realitet?”, Rama diskutoi sfidat e anëtarësimit dhe nevojën për një qasje më të drejtë dhe të barabartë ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Forumin Strategjik të Bledit 2025 dëshmoi se vendi është jo vetëm një aspirant për anëtarësim në BE, por edhe një kontribuues aktiv në dialogun strategjik ndërkombëtar. Me një qasje të balancuar, vizion të qartë dhe diplomaci të artikuluar, Shqipëria u pozicionua si një zë i rëndësishëm për stabilitetin dhe bashkëpunimin në Evropën Juglindore.

NATO si Aktor Global në Dialogun Strategjik

Pjesëmarrja e NATO-s në BSF 2025 nuk u kufizua vetëm në çështjen ukrainase. Përfaqësuesit e Aleancës morën pjesë në diskutime mbi:



Zëvendëssekretarja e Përgjithshme pohon mbështetjen e fortë të NATO-s për Ukrainën në Bled, Slloveni



- Riformatimin e arkitekturës së sigurisë globale
- Sfida të reja hibride dhe kibernetike
- Rolin e NATO-s në Ballkanin Perëndimor dhe Detin Baltik

Në sesionet e mbyllura, përfaqësuesit e NATO-s zhvilluan takime bilaterale me liderë rajonalë, duke riafirmuar angazhimin për stabilitetin në Evropën Juglindore dhe për integrimin e vendeve partnere në strukturat euroatlantike.

Dialog me Partnerët: Ballkani në Fokus

Në margjinat e forumit, NATO zhvilloi takime me përfaqësues të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi, duke diskutuar për stërvitjet e përbashkëta, ndihmën në ndërtimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e sigurisë kufitare. Shekerinska përgëzoi rolin e Shqipërisë si vend pritës i stërvitjes “Defender Europe 25” dhe vlerësoi kontributin e saj në misionet e NATO-s.

NATO, Shtylla e Sigurisë në Kohë të Paqarta

Pjesëmarrja e NATO-s në Forumin Strategjik të Bledit 2025 ishte një dëshmi e qartë e rolit të saj si aktor kyç në arkitekturën globale të sigurisë. Në një botë ku kërcënimet janë gjithnjë e më të ndërlikuara – nga agresioni konvencional te sulmet kibernetike – Aleanca mbetet e vendosur për të mbrojtur paqen, për të ndërtuar partneritetet dhe për të udhëhequr dialogun strategjik.

Forumi i Bledit nuk ishte thjesht një konferencë – ishte një platformë ku NATO dëshmoi se siguria nuk është luks, por domosdoshmëri. Dhe në këtë rrugëtim, Aleanca mbetet e gatshme të udhëheqë me vizion, vendosmëri dhe solidaritet.

Nëse dëshiron ta përshtatim këtë tekst për një komunikatë zyrtare, artikull analitik apo editorial për media ndërkombëtare, jam gati ta rafinoj më tej.

Rolet kryesore të NATO-s, siç u diskutuan gjatë Forumit Strategjik të Bledit 2025:

Lidershipi i Sigurisë dhe Mbrojtjes

Riafirmoi angazhimin e saj për mbrojtjen kolektive sipas Nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit dhe theksoi praninë e saj strategjike në Evropën Lindore dhe rajonin e Baltikut për të penguar agresionin.

Mbështetje për Ukrainën

- Prezantoi Listën e Kërkesave Prioritare për Ukrainën (PURL), duke mobilizuar mbi 2 miliardë dollarë ndihmë.

- Theksoi bashkëpunimin afatgjatë përmes strukturave si Këshilli NATO-Ukrainë dhe qendrat e përbashkëta të trajnimit.

Dialogu Strategjik Global

- Mori pjesë në panele mbi qeverisjen globale, kërcënimet hibride dhe rezistencën kibernetike.

- Avokoi për partneritete më të forta në Ballkanin Perëndimor dhe Krahun Lindor.

Angazhimi Rajonal

- Mbajti takime dypalëshe me udhëheqës nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

- Promovoi stabilitetin rajonal përmes ushtrimeve të përbashkëta dhe iniciativave për ndërtimin e kapaciteteve.

Siguria Kibernetike dhe Inovacioni

- Propozoi krijimin e një Komande të Përbashkët Kibernetike të NATO-s për të koordinuar mbrojtjen dixhitale.

- Theksoi rëndësinë e mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe sovranitetit dixhital.

NATO e përdori forumin për të përforcuar rolin e saj si një forcë stabilizuese, një partner strategjik dhe një aleancë që shikon përpara në një peizazh sigurie që evoluon me shpejtësi.

2 SHTATOR 1945: USS MISSOURI – FUNDI I LUFTËS, LINDJA E NJË BOTE



80 vjet nga dorëzimi i Japonisë dhe fjalët historike të MacArthur-it: “Nga gjaku dhe tmerri, të lindë një botë e re”

6 gusht 1945

Bomba atomike në Hiroshima

140,000 viktima; fillimi i fundit të luftës

15 gusht 1945

Dorëzimi i Japonisë

Fundi i luftimeve në Paqësor

2 shtator 1945

Ceremonia në USS Missouri

Fundi zyrtar i Luftës së Dytë Botërore

Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore u bë i mundur për disa arsye. Rrënjët e saj duhen kërkuar në përfundim të Luftës së Parë Botërore kur në Konferencën e Paqes në Paris, në vitet 1919-1920, shtetet fituese të saj vendosën kushte të rënda penalizuese e kufizuese politike, ekonomike dhe ushtarake ndaj shteteve të mundura si dhe aneksime territoriale. Traktatet e nënshkruara mbollën farën e pakënaqësisë sidomos në Gjermani, e cila me kalimin e viteve u rrit e u zgjerua dhe u shfrytëzua nga qarqe ekstreme të djathta e nacionaliste për të organizuar lëvizje dhe organizata politike me platforma revanshiste. Kështu lindën partitë fashiste në Gjermani, Itali apo vende të tjera, ku në qendër të programeve të tyre u vendosën ideologji raciste, ekspansioniste e luftënxitëse. Një arsye tjetër, ishte se sistemi i ri ndërkombëtar, i njohur ndryshe edhe si sistemi i Versajës që u inaugurua pas Konferencës së Paqes në Paris së bashku me Lidhjen e Kombeve që u krijua, nuk garantuan, siç u shpall, ruajtjen e paqes e të sigurisë ndërkombëtare. Ato dështuan të pengonin edhe thyerjen e kufizimeve ushtarake të parashikuara në traktatet për shtetet e mundura si dhe aktet e para agresive kundër vendeve të tjera siç ishte pushtimi i Mançurisë nga Japonia, në vitin 1931, dhe fillimi i Luftës së dytë sino-japoneze në 1937, pushtimi i Etiopisë në 1935 dhe i Shqipërisë në 1939 nga Italia fashiste, “bashkimi” me dhunë i Austrisë me Gjermaninë në vitin 1938 dhe pushtimit prej saj të Çekosllovakisë në mars 1939. Jo vetëm kaq, por fuqitë perëndimore europiane, Britania e Madhe e Franca si dhe shteti sovjetik, pasi dështuan në përpjekjet e tyre për të krijuar një front antifashist, ndoqën politikën e lëshimeve e të kompromiseve me Gjermaninë naziste për të shmangur gjithsecili rrezikun për vete dhe duke inkurajuar Hitlerin kundër të tjerëve. Të kësaj natyre ishin Marrëveshja e Munihut e shtatorit 1938 midis Francës e Britanisë së Madhe me Gjermaninë e Italinë, dy nga tre vendet e Boshtit fashist (Berlin – Romë – Tokio), arritur në vitin 1936. Sipas kësaj Marrëveshjeje, Gjermania lejohej të fuste trupat e saj pushtuese në krahinën e Sudeteve të Çekosllovakisë, ngjarje kjo që gjashtë muaj më vonë përfundoi me pushtimin e gjithë vendit.

Në thelb edhe qeveria sovjetike bëri të njëjtin veprim. Pas disa muajsh negociatash të fshehta, të shoqëruara edhe me shkëmbime letrash mes Hitlerit e Stalinit, në gusht 1939 në Moskë u nënshkrua Traktati i fshehtë sovjeto-gjerman, i njohur ndryshe Traktati Ribentrop-Molotov. Ky traktat i arritur në sekret të plotë disa ditë para agresionit nazist kundër Polonisë i hapi përfundimisht dritën jeshile pushtimit të këtij vendi, ndarjen territoriale të tij dhe të zonave të influencës në shtete të tjera rreth tij.

Këtë vit mbushen 80 vjet nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Rimëkëmbja e botës nga kjo luftë, që përfundoi në vitin 1945 dhe ndryshoi botën, ishte një rrugë e gjatë dhe e vështirë. Tetëdhjetë vjet më parë bota ishte përfshirë nga konflikti, por në fillim të vitit 1945 Luftës së Dytë Botërore po i afrohej fundit.

TOKIO – Tetëdhjetë vjet më parë, më 2 shtator 1945, në Gjirin e Tokios, luftanija amerikane “USS Missouri” u shndërrua në skenën e fundit të Luftës së Dytë Botërore. Atje, përballë përfaqësuesve të 9 kombeve aleate, gjenerali Douglas MacArthur pranoi dorëzimin e pashmangshëm të Japonisë. Ky akt simbolik, i njohur si “Dita V-J” (Victory over Japan), shënoi fundin zyrtar të konfliktit më të përgjakshëm në historinë e njerëzimit, që kishte lënë 70-85 milionë të vdekur dhe kontinente në rrënoja.

Ceremonia e Paqes në Detin e Tokios

Në orën 9:02 të mëngjesit, me një qiell të qartë mbi Gjirin e Tokios, 26 minuta pasi bomba atomike kishte shkatërruar Nagasakin, luftanija “USS Missouri” u mbush me heshtje. Në tryezën e dorëzimit, të veshur me një mbulesë jeshile të errët, u vendosën dy dokumente: njëri për aleatët, tjetri për Japoninë. Ministria e Jashtme japoneze, Mamoru Shigemitsu, dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Yoshijiro Umezu, nënshkruan aktin me duar të dridhura. Pas tyre, MacArthur, përfaqësuesi i SHBA-së, nënshkroi për 9 kombe aleate, duke përdorur 5 penë: një për SHBA-në, një për Kinën, dhe tre për aleatët e tjerë.

Fjalët që Ndryshuan Botën

Me zë të qetë por të fortë, MacArthur iu drejtua të pranishmëve: “Sikurse i gjithë njerëzimi, unë shpresoj që nga ky moment i rëndësishëm, të lindë një botë më e mirë – një botë e ndërtuar mbi dinjitetin njerëzor, lirinë, tolerancën dhe drejtësinë”.

Këto fjalë, të dëgjua nëpërmjet radiove në mbarë botën, u bënë simbol i një epoke të re.

Nga Hiroshima deri në USS Missouri: Rruga e Dorëzimit 15 gusht 1945: Perandori Hirohito njoftoi dorëzimin e Japonisë pas bombardimeve atomike të Hiroshimës (6 gusht) dhe Nagasakit (9 gusht), dhe sulmit sovjetik në Mançuri.

2 shtator 1945: Ceremonia zyrtare në “USS Missouri”. Flota aleate, me 258 anije luftarake, rrethoi luftanijen si një “mur çeliku”.

Lufta që Ndryshoi Rregullin Botëror

Lufta e Dytë Botërore (1939–1945) nisi nga rrënjët e Luftës së Parë Botërore: Traktati i Versajës (1919) dështoi të zgjidhte tensionet, duke lënë Gjermaninë në varfëri dhe revanshizëm.

Boshti Fashist (Gjermani-Itali-Japoni) shfrytëzoi krizën për të nisur pushtime: Polonia (1939), Franca (1940), Bashkimi Sovjetik (1941), dhe Azia Juglindore (1941–1942).

Kambana e Paqes duhet të bëhet më e fortë se Arma: “MacArthur e kuptonte se paqja nuk është vetëm mungesa e luftës, por ndërtimi i një sistemi të drejtësisë. Sot, kur shohim konflikte në Ukrainë ose tensione në Detin e Kinës, duhet të kujtohem: USS Missouri nuk ishte vetëm një luftanije, por një mësim për bashkëpunimin global”.

Mësimet për Botën e Sotme

Dështimi i Kompromiseve me Tiraninë: Politika e lëshimeve ndaj Boshtit në vitet '30 çoi në katastrofë. Sot, dialogu me regjime autoritare duhet të shoqërohet me forcë të bashkërenduar.

Rreziku i Armëve të Shkatërrimit në Masë: Bomba atomike tregoi se teknologjia pa kontroll moral çon në gjenocid. Traktati i Non-Proliferimit (1968) mbetet i domosdoshëm.

Roli i OKB-së si trashëgimtare e Aleatëve: Themeluar në 1945, OKB-ja është përpjekja për të shmangur një tjetër USS Missouri.

Nga USS Missouri në Sallën e OKB-së: 80 Vjet Përkujtim

80 vjet më vonë, USS Missouri qëndron ende në Pearl Harbor si muze, ndërsa fjalët e MacArthur-it jehojnë në Sallën

e Përgjithshme të OKB-së. Lufta e Dytë Botërore na mësoi se paqja nuk fitohet vetëm me armë, por me dinjitet. Siç thoshte gjenerali: “Liria nuk është e lirë – kushton gjak, sakrificë dhe përgjegjësi”. Për ushtrinë shqiptare, kujtesa e 2 shtatorit 1945 është detyra për të mbrojtur këto vlera.

Lufta e Dytë Botërore ka lënë gjurmë të pashlyeshme në memorien kolektive të kombeve. Zëvendësimi i brezave njerëzorë, distancimi kohor nga vetë ngjarja, natyrshëm ka tendencë të zbeh vetë ngjarjen por mbi të gjitha përgjegjësitë e atyre që përgatitën Luftën, që shkaktuan dramën më të madhe në historinë e njerëzimit, holokaustin, që mbollën tmerre apokaliptike e që ende shfaqen gjurmët e krimeve e të traumave mizore. Që e keqja të mos përsëritet e për më tepër të mos shumëfishohet është domosdoshmëri që sot e në të ardhmen të vazhdojë përballja kritike me Luftën e Dytë Botërore, që brezat e rinj përmes edukimit historik të ushqehen me njohuri objektive, të respektojnë e të vlerësojnë kontributet në mbrojtje të lirisë, të progresit dhe të identitetit kombëtar. Kujtesa duhet të shërbejë si një moment reflektimi dhe si një busull morale për një të ardhme më të drejtë, paqësore dhe të qëndrueshme për të gjitha kombet.



IN MEMORIAM

Dashamir Fagu, sportist elitar dhe mësues i skënderbegasve

Dashamir Fagu, ose siç e thërrisnin të gjithë, “Dashi”, mbetet një nga figurat më të ndritura të volejbollit shqiptar dhe një ndër personalitetet më të dashura të arsimit fizik në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”.

Ai lindi në vitin 1950 dhe u nda nga jeta në mënyrë të papritur, më 3 gusht 1991, në moshën 41-vjeçare. Edhe pse jeta e tij ishte e shkurtër, ndikimi që pati në sportin shqiptar dhe në edukimin e brezave është i përjetshëm.

Dashamir Fagu spikati herët si talent i rrallë në volejboll dhe u bë elitë falë punës me profesorët Masar Aga dhe Petrit Murzaku. U bashkua me ekipin e parë të “Partizanit” në moshën 18-vjeçare dhe për gati 15 vite u bë shtylla kryesore e këtij klubi dhe e ekipit kombëtar të Shqipërisë.

Ai u dallua për fizikun e tij mbresëlënës, teknikën e përsosur dhe lidërsipin në fushë. Ishte një ndër figurat kryesore që e mbajti “Partizanin” në elitën e volejbollit shqiptar përkundër dominimit të “Dinamos” në ato vite.

Me “Partizanin” fitoi tre kampionate (1973, 1976, 1981), tre Kupa Republike (1971, 1974, 1982) dhe Spartakiadën Kombëtare të vitit 1974.

Në arenën ndërkombëtare, ai ndihmoi në eliminimin e kampionëve të Turqisë dhe Italisë në Kupën e Kampioneve të Europës 1973-1974.

Pas tërheqjes nga sporti aktiv në vitin 1983, ai i përkushtoi jetën mësimdhënies dhe edukimit fizik në shkollën “Skënderbej”, ku u vlerësua jo vetëm për profesionalizmin, por edhe për karakterin e tij të drejtë dhe frymëzues.



Dashamir Fagu, (1950 – 3 gusht 1991)



Vdekja e tij në rrethana të pasqaruara, në kulmin e jetës dhe shëndetit, tronditi familjen, shokët, sportdashësit dhe nxënësit e tij.

Dashamir Fagu nuk ishte vetëm një sportist i klasit të lartë, por një njeri i veçantë që la pas një trashëgimi të madhe njerëzore dhe profesionale.

Kastriot Ago, zëri brilant që nuk shuhet kurrë

Kastriot Ago mbetet një nga figurat më të paharruara të muzikës së lehtë shqiptare. Me një zë brilant dhe një shpirt të madh, ai preku zemrat e publikut dhe la një trashëgimi të pavdekshme artistike.

Lindi në Korçë, më 1954, dhe që në moshë të re spikati për talentin e tij muzikor. Ishte shkolla ushtarake “Skënderbej” ajo që zbuloi dhe formoi zërin e tij të jashtëzakonshëm, duke i dhënë skenës shqiptare një tenor të rrallë.

Një jetë mes uniformës dhe artit

Kastrioti, i njohur me përkëdheli si Kaçi, ishte shembulli i artistit që nuk u ndal përballë vështirësive. Pasi u diplomua si oficer, ai për një kohë u largua nga skena për shkak të detyrimeve ushtarake, por pasioni për muzikën nuk iu shua kurrë. Kthehet në Tiranë dhe triumfon në Koncertet e Majit me Ansamblin e Ushtrisë Popullore, duke fituar Çmimin e Parë.

Këngët që i dhanë emër

Kastriot Ago ka lënë pas një repertor të pasur me këngë që ende këndohen sot:

- “Bora s’ka ndërmend të shkrijë”
- “Europa ëndrra jonë” (me Mimoza Selimin)
- “Nëpër dete e oqeanë” (me Bahri Rustjen)
- “Më s’të besoj”
- “Kënga fitimtare” e shumë të tjera që shoqërojnë kujtimet e një kohe kur muzika ishte art, dhe artistët si Kastrioti, ishin frymëzim.

Përtej kufijve

Një nga ëndrrat më të mëdha të Kastriotit ishte të këndonte jashtë Shqipërisë, dhe ia doli, pavarësisht pengesave politike të kohës ai përfaqësoi vendin në Kalabri, Itali, me një interpretim të paharruar të “O Sole Mio”.



Humbja dhe trashëgimia

Humbja e tij e papritur në SHBA tronditi miqtë, kolegët dhe dashamirësit. Ndonëse fizikisht nuk është më mes nesh, Kastriot Ago jeton në zërin e këngëve që na la, në kujtimet e shokëve dhe në historinë e artit shqiptar.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!

Gratë dhe vajzat pogradecare, shpirti i bazave të Luftës Nacionalçlirimtare



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Nuk dihet fati i Flamurit të Pavarësisë në Pogradec

Ishin Gjakë Kondakçiu, Muamer Minarolli dhe patriotë të tjerë pogradecarë që menjëherë, pak javë pas ngritjes së flamurit nga Ismail Qemali në Vlorë, ngritën flamurin e çlirimit në qytetin e Pogradecit. Gjoka e ruajti flamurin me kujdesin më të madh deri në vitin 1940, që ishte viti i vdekjes së tij. Bashkëshortja e tij, Frosa Atstefan Kondakçiu mbas vdekjes së Gjakës, flamurin e mbajti dhe e ruajti si gjënë më të shtrenjtë, deri në çlirimin e atdheut nga nazi-fashizmi.

Frosa Kondakçiu u bë një nga aktivistet më të dalluara të gruas antifashiste. Ajo u përfshi në bashkëbisedim dhe në veprimtari me disa nga gratë më të shquara të organizatës së gruas antifashiste të rrethit të Pogradecit. Midis tyre gjatë luftës u shquan Athina Gjakë Vako, e cila ishte nëna e dëshmorit trim Minash Gjoka; Lisaveta Prifti, motra e luftëtarit Nuçi Tira; Vika Llakmani, motra e partizanit të kulturuar Piro Vako; Tefta Marko, e shoqja e Naum Markos të internuar në Itali nga fashistët italianë, për shkak të armëve që gjetën në shtëpinë e tij; Parake Vako, nëna e dirigjentit të talentuar Milto Vako; Vangjë Ambo, e shoqja e partizanit Kopi Ambo; Vangjë Stefan Poçari, motra e vëllezërve Tushi, Gjakë, Marko. Marko Poçari i mbiquajti "Marko Katili" për trimërinë e tij në Luftën Antifashiste, që për urtësinë, dashurinë, mirësinë e mençurinë, provoi shumë detyra informatori, brenda e jashtë vendit, Erefilin Laçka nëna e dëshmores Tomka Laçka etj.

Të gjitha së bashku dhe të organizuara nën drejtimin e Partisë Komuniste dhe të Frontit Nacionalçlirimtar në Pogradec, u organizuan në organizatën antifashiste të gruas. Ato u organizuan dhe në vitin 1942, mbi 200 gra pogradecare dhe nga fshatrat rreth tij, u paraqitën pranë komandës së karabinierisë mbretërore për të kërkuar miell, për bukën e gojës së fëmijëve të tyre. Ndërsa në prill të vitit 1943 në Pogradec, gratë, si në shumë qytete të vendit, shpërthyen në demonstrata kundër internimit të të burgosurve në Itali dhe për lirinë e atyre që mbaheshin në burgje pa u gjykuar. Në ballë të tyre printe Flamuri i Pavarësisë, i ruajtur me shumë kujdes nga vetë ato.

Më çlirimin e vendit, organizata e gruas vendosi dhe e ekspozoi Flamurin e Pavarësisë në zyrat e gruas në Pogradec. Me inaugurimin e muzeut të parë në rrethin e Pogradecit, Flamuri i Pavarësisë dhe i çlirimit nga zgjedha otomane dhe pushtuesit e shumtë, u ekspozua në këtë muze (Petro Prifti, "Gjakë Risto Kondakçi, jeta dhe vepra patriotike", Pogradec, 2003, f. 12-13). Me ndryshimin e sistemit, transferimet e muzeut, si dhe shkatërrimi i tij në vitin e mbarsht 1997, nuk dihet më se ku ndodhet Flamuri i Pavarësisë.

Gratë – mbajtësit e hapura bazat e Luftës Nacionalçlirimtare

Për organizimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare kusht i domosdoshëm ishte krijimi i një prapavije të fortë dhe të qëndrueshme. Në aspektet më të rëndësishme të kësaj prapavije ishin bazat, si pikëmbështetje të sigurt të gjithë veprimtarisë ilegale të Frontit dhe të Partisë.

Këto baza të Luftës Nacionalçlirimtare nuk do të ishin shtëpi për të strehuar e për të mbrojtur, por në kuptimin e plotë të tyre ato nuk do të ishin vetëm shtëpi për të strehuar e për të mbrojtur një ose disa ilegalë, por qendra. Në këto shtëpi do të hynin e dilnin vazhdimisht legalë e ilegalë, do të hartoheshin plane për të goditur armikun, do të shkruheshin e shtypeshin trakte e komunikata, të cilat do të niseshin në drejtime të ndryshme për t'u shpërndarë në fshatra e deri në radhët e armikut, në qendra ku drejtoheshin çetat partizanë dhe nga ku do të niseshin rinjtë për të kryer aksione me njësitet guerile etj.

Në pozitën shoqërore që ndodhej Shqipëria në atë kohë, ishin burrat kryetarët e familjes që në përgjithësi vendosnin krijimin e këtyre qendrave. Por shtëpitë e popullit nuk mund të shndërroheshin në baza të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të luanin rolin si të tilla, pa pjesëmarrjen e ndërgjegjshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes dhe në radhë të parë të grave.

Kërkesa e parë dhe e natyrshme për çdo njeri që lidhej me Lëvizjen ishte kthimi i shtëpisë, në strehë për ilegalë, për veprimtarinë e tyre. Kështu, bazat e para në qytet e në fshat u bënë shtëpitë e luftëtarëve të komunistëve dhe të patriotëve të vendosur për çlirimin e atdheut. Por dhe shtëpitë e punëtorëve e të zejtarëve, të qytetarëve të varfër e intelektualëve përparimtarë, që të parët përqaftuan Lëvizjen Nacionalçlirimtare u kthyen dhe ato në baza të fuqishme.

Në këto shtëpi filluan të dëndësoheshin lëvizjet. Por në sytë



kureshtarë me gjithë kujdesin e konspiracionin e madh, shikohej se hynin e të dilnin fytyra të reja që nuk ishin as të afërmit, e as të shtëpisë. Çdo kureshtje mund të bëhej shkak dhe të shkonte në vesh të armikut. Çdo ditë jeta po i përgatiste dhe po i mësonte gratë se si të vepronin në situata të vështira. Gratë dhe vajzat u kujdesën për t'i mbrojtur këto baza. Lëvizja Nacionalçlirimtare po kuptohej tani nga gratë e nga burrat, nga gjithë familjet që ndodheshin rreth e rrotull bazave të para, të cilat shkallë-shkallë dhe ato vetë u bënë baza të luftës së madhe për liri.

Patriotë të shumtë i kthyen shtëpitë e tyre në baza të luftës. Populli i Pogradecit, gra e burra, pleq e të rinj u bënë roje vigjilente të tyre. Fëmijët që luanin në rrugë ruanin e përgjonin lëvizjet e armikut, mashtronin e çorientonin patrullat armike, spiunët e tradhtarët që vepronin për të zbuluar bazat ilegale në Pogradec.

Duke e vlerësuar drejt rolin e madh që do të luante gruaja në Luftë në përgjithësi dhe në prapavijat e saj në veçanti, Fronti dhe Partia i kushtuan, që në fillim, kujdes të veçantë punës me gratë dhe vajzat, si dhe tërheqjes së tyre në aktivitete nga më të ndryshmet për t'i hedhur ato gradualisht në praktikën luftarake.

Gratë dhe vajzat po kaliteshin e po formoheshin politikisht dhe shpejt ato u bënë ndër faktorët vendimtarë në prapavijë, u bënë shpirti i bazave të Luftës.

Gratë pogradecare mbajtën shtëpitë të hapura në çdo kohë, pritën natën dhe ditën me të ngrenë e me të pirë, me të shtruar e me të mbuluar. Që në fillim të luftës kur burrat u hodhën të parët në rreshtat partizane, ishin gratë që strehonin e mbronin bijtë e bijat e popullit, luftëtarët e lirisë, shumicën e të cilëve as e kishin njohur e as e kishin parë ndonjëherë. Gratë e vajzat në qytet, e veçanërisht në fshat, i prisnin luftëtarët e luftës, u shërbenin e bisedonin me ta, si me të afërmit e tyre.

Më heroike ishte veprimtaria e nënave dhe grave të cilave iu kishin rënë bijtë dhe burrat në luftë. Ato u bënë burra në familje dhe hapën shtëpitë e tyre, duke i kthyer në qendra të veprimtarisë ilegale. Baza të tilla patën vlerë të veçantë, se armikut më pak i shkonte mendja se mund të zhvillohej veprimtari revolucionare e të bëheshin mbledhje ilegale në këto shtëpi pa burra.

Bazat e para dhe nga më të rëndësishmet të luftës në Pogradec ishin shtëpitë e Qerime Çollakut, Athina Vakos, Hajrie Minarollit, Milika Shukes, Vangje Lackës, Lisaveta Priftit, etj., të këtyre grave të thjeshta, trime e të vendosura, që bashkë me fëmijët e tyre iu kushtuan deri në fund luftës.

Gra dhe vajza – dëshmore dhe luftëtare pogradecare

Një kontribut të madh dhanë dhe treguan edhe gratë pogradecare, të cilat shfaqën aftësi të rralla organizimi, drejtimi dhe morale. Aktet e trimërisë dhe heroizmit të grave e vajzave gjatë LANÇ-it, të përlëshjeve me armiqë janë të panumërta, midis tyre ranë në fushën e nderit dhe të trimërisë pesë gra dhe vajza pogradecare. Ato janë: Pulherie Petraq Kole, që u bë veprimtare e shquar e lëvizjes, duke shndërruar shtëpinë e saj në Pogradec në një bazë të rëndësishme ilegale për aktivitetet e luftës. Meriko Selmanllari u bë një veprimtare e shquar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, e ktheu shtëpinë e saj në bazë të luftëtarëve të lirisë në Gorë, duke u ndihmuar dhe nga e bija Shqipërie. Ndër gratë aktiviste në Gorë, në periudhën e lëvizjes u shquan Medije Braçe, e cila ishte dhe delegate në Kongresin e Gruas Antifashiste në Berat, në nëntor 1944, Fiqirie Kolaneci, aktiviste e shquar e gruas në krahinë, Nënë Pashako, trimëreshë dhe legjendë e gruas gjatë LANÇ-it, Fike Grybeci, anëtare e Organizatës së Gruas

Antifashiste në Gorë, si dhe Meriko Selmanllari, aktiviste e gruas në krahinë. Liri Andon Çomo shtëpinë e saj e ktheu në bazë të Luftës Nacionalçlirimtare. Në radhët e partizanëve të rinj, ajo dukej si grua e pjekur, motër me përvojë. Prandaj shumë prej tyre e thërrisnin nënë, të tjerët motër. Në batalionin e Mokrës ajo kryente detyrën e infermieres. Në kohën e lirë armonte rrobat e partizanëve. Tomkë Laçka, në maj 1944, u gjend në formacionin e batalionit të Mokrës, partizane e vogël, gojëmbël, që kishte nisur rrugën e revolucionit... Ishte një vajzë e re dhe s'të mbushej mendja, se ishte pikërisht ajo që u mësonte shoqeve të saj të shkruanin e të këndonin, apo t'i bindte me fjalët e saj të rejtat që të shkonin në batalionin partizan. Kështu veproi kur ishte partizane në batalionin "Reshit Çollaku", kështu veproi dhe në radhët e batalionit tretë të Brigadës XV Sulmuese.

Atdhetarizmi i njohur i gruas shqiptare, cilësitë e rralla morale të saj, morën një përmbajtje të re dhe u shfaqën me forcë në ato gra e vajza të popullit që ngjeshën amët dhe luftuan krah për krah me burrat gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pjesëmarrja e gruas në LANÇ ishte një nga risitë më të mëdha të asaj epopeje. Në radhët e Ushtrisë NÇ u rreshtuan rreth 6.000 gra e vajza. Ato dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm në luftë kundër nazi-fashizmit, por edhe kundër pengesave e besëtytnive shekullore.



Pse SHBA dhe Kina ende investojnë në armë me ekuipazh, kur ekzistojnë dronët?

Megjithëse armët autonome ofrojnë avantazhe, ekspertët theksojnë se roli i njeriut mbetet thelbësor në vendimmarrje dhe operacione luftarake. Kina synon të modernizojë ushtrinë e saj, ndërsa dronët nuk po zëvendësojnë ushtarët, por po ndryshojnë mënyrën si ata veprojnë. Teknologjitë e avancuara të dronëve dhe robotikës po transformojnë natyrën e luftës bashkëkohore, shkruan “South China Morning Post”.

Nga qentë robotikë te dronët inteligjentë, Kina dhe SHBA po zhvillojnë teknologji ushtarake që mund të luajnë rol kyç në betejat e së ardhmes, me njerëzit të pozicionuar në qendra komande larg vijës së frontit. Pesë vite më parë, Xi Jinping theksoi se operacionet pa pilot po transformojnë luftën dhe kërkoi përshpejtimin e përdorimit të dronëve nga ushtria kineze. Ndërkohë, SHBA ka prezantuar një strategji të re në Azi, duke planifikuar vendosjen e tufave të dronëve rreth Tajvanit për mbrojtje ndaj një sulmi të mundshëm nga PLA.

Figurat e njohura, përfshirë Elon Musk – drejtuesin e SpaceX dhe Tesla – kanë deklaruar se investimi në sisteme të avancuara armësh me ekuipazh është tashmë i paarsyeshëm, duke argumentuar se përparimi i dronëve e bën këtë qasje të vjetëruar. Musk ka paralajmëruar madje se vazhdimi i kësaj strategjie “minon rëndë sigurinë tonë kombëtare”.

Megjithatë, pavarësisht përfitimeve të dukshme që sjellin armët autonome – si reduktimi i viktimave dhe kostove njerëzore – fuqitë kryesore ushtarake si Kina, SHBA, vendet evropiane, Japonia dhe Rusia vazhdojnë të investojnë në sisteme të kushtueshme me ekuipazh, përfshirë avionët luftarakë të gjeneratës së gjashtë.

Këto avionë janë projektuar për të bashkëpunuar ngushtë me dronë të njohur si “besnikë të krahut”, duke synuar të sigurojnë superioritet ajror. Sipas analistëve, ky model mbetet tërheqës për shkak të fleksibilitetit operacional, pavarësisht rreziqeve të reja që mund të sjellë përdorimi i inteligjencës artificiale në konfliktet e armatosura.

Përveç kësaj, Kina, SHBA dhe ushtri të tjera po vazhdojnë të ndërtojnë kapacitete detare me sisteme me ekuipazh, si transportuesit e avionëve, të cilët shërbejnë si mjete strategjike për të dërguar mesazhe parandalimi përtej kufijve të tyre bregdetarë.

Sipas analistëve, roli i njeriut do të mbetet thelbësor në vendimmarrje dhe operacione luftarake. Ata argumentojnë se sistemet tradicionale nuk mund të zëvendësohen plotësisht, për shkak të kufizimeve teknologjike si ndjeshmëria e dronëve ndaj ndërhyrjeve elektronike, si dhe për shkak të dilemave etike që lidhen me përdorimin e sistemeve autonome në luftë.

“Dronët po fitojnë gjithnjë e më shumë rëndësi në fushën e betejës dhe padyshim po i shtojnë kapacitetet njerëzore në mënyra të reja dhe të fuqishme”, - thotë Kateryna Bondar, eksperte e inteligjencës artificiale dhe çështjeve ushtarake në Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare në Uashington. “Megjithatë, ata nuk kanë zëvendësuar as njerëzit dhe as platformat tradicionale – dhe nuk pritet ta bëjnë këtë në një të ardhme të afërt”.

Bondar thekson se në mjediset ajrore dhe detare, ku dronët ofrojnë përparësi në rreze veprimi dhe qëndrueshmëri, sistemet me ekuipazh mbeten të domosdoshme. “Një avion luftarak i së ardhmes mund të kontrollojë një numër të madh sistemesh autonome, por do të mbetet një avion me ekuipazh – shumë i aftë dhe qendror për projeksionin e fuqisë.”

Mësimet nga Ukraina

Lufta në Ukrainë ka shërbyer si një laborator i gjallë për përdorimin e dronëve në konfliktet moderne, me të dyja palët që kanë vendosur sisteme pa pilot në një shkallë të gjerë. Efikasiteti i dronëve ukrainas është dëshmuar në disa operacione të suksesshme kundër flotës së Detit të Zi të Rusisë. Në shkurt të vitit të kaluar, ata arritën të fundosin anijen zbarkuese amfibe Caesar Kunikov dhe korvetën raketore “Ivanovets”. Vetëm një muaj më pas, dronët detarë ukrainas “neutralizuan” anijen patrulluese “Sergei Kotov” pranë Ngushticës Kerç, që lidh Detin e Zi me Detin Azov, sipas burimeve të inteligjencës ushtarake ukrainase.

Më 1 qershor të këtij viti, Ukraina ndërmori një operacion të bujshëm të quajtur “rrjeta e merimangës”, ku mbi 100 dronë goditën bazat ajrore brenda territorit rus, duke shkatërruar të paktën 13 bombardues me rreze të gjatë veprimi, të aftë për të mbajtur armë bërthamore.

Megjithatë, pavarësisht suksesit të tyre, dronët nuk janë pa kufizime. Sipas disa vlerësimeve, Ukraina humbet rreth 10,000 dronë në muaj, kryesisht për shkak të ndërhyrjeve elektronike dhe bllokimeve. Analistët paralajmërojnë se dronët nuk janë një zgjidhje universale.

Timothy Heath, studiues i lartë në Korporatën RAND, thekson se ndonëse dronët kanë qenë jashtëzakonisht efektivë, roli i avionëve të pilotuar mbetet i pazëvendësueshëm. “Avionët me ekuipazh mund të komandojnë dhe kontrollojnë dronët nga ajri, duke i dhënë komandantit një pamje më të qartë dhe një kuptim më të thellë të hapësirës së betejës. Për më tepër, ata janë më pak të ndjeshëm ndaj bllokimeve sesa dronët”, - tha Heath. Ai shton se përzierja e platformave me dhe pa ekuipazh pritet të evoluojë, me një prirje në



rritje drejt dronëve në të ardhmen.

Kateryna Bondar, eksperte e inteligjencës artificiale dhe çështjeve ushtarake në Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare në Uashington, vëren se si Ukraina dhe Rusia kanë vendosur dronë në një shkallë të paprecedentë – nga kuadrokopterët e zbulimit, te municionet me rreze të gjatë dhe dronët detarë. Por sipas saj, kjo nuk ka bërë që sistemet tradicionale të dalin jashtë përdorimit.

“Pavarësisht nivelit të avancuar dhe përhapjes së gjerë të dronëve, fitorja në fushën e betejës ende varet nga intensiteti i zjarrit, mbështetja logjistike dhe koordinimi efektiv i armëve të kombinuara”, - shpjegon Bondar. E njëjta logjikë vlen edhe për operacionet detare në ujëra të hapura. “Mjetet sipërfaqësore dhe nënujore pa ekuipazh ofrojnë kapacitete të reja, por në hapësira të mëdha detare ato do të kontrollohen dhe koordinohen nga anije me ekuipazh, të cilat mbeten qendra strategjike dhe komanduese”. Në vend që t'i zëvendësojnë sistemet tradicionale, dronët po riformësojnë taktikat dhe po ripërcaktojnë rolet në fushën e betejës. Ata zgjerojnë shtrirjen operacionale, përmirësojnë mbijetesën dhe mundësojnë reagim më të shpejtë. Për momentin, dhe në të ardhmen e parashikueshme, dronët mbeten pjesë e një arkitekture më të gjerë të luftës së kombinuar – jo një zëvendësim për të.

“Më e mira e të dy botëve”

Me avancimin e vazhdueshëm të teknologjisë së dronëve dhe mënyrave gjithnjë e më të sofistikuara për t'i përdorur, ushtritë po eksplorojnë gjithashtu konceptin e bashkëpunimit mes platformave me pilot dhe atyre autonome — një model ku njerëzit dhe sistemet pa pilot punojnë së bashku në operacione të koordinuara.

Në Shtetet e Bashkuara, avioni luftarak i gjeneratës së gjashtë F-47, pjesë e programit të Dominimit Ajror të Gjeneratës së Ardhshme, është projektuar si një “sistem sistemesh”, me një avion të pilotuar në qendër që komandon një grup dronësh. Kina, nga ana e saj, besohet se po ndjek një qasje të ngjashme me avionët e saj luftarakë të gjeneratës së gjashtë, J-36 dhe J-50, të cilët janë parë në imazhe të paverifikuara që qarkullojnë në mediat sociale që prej dhjetorit. Analistët sugjerojnë se këto platforma të avancuara mund të përdoren për të fluturuar në koordinim me dronë.

Ushtria Çlirimtare Popullore e Kinës po eksperimenton gjithashtu me dronët e njohur si “pilotët besnikë të krahëve”, të cilët mund të operojnë në sinkron me avionët e saj luftarakë të fshehtë J-20, veçanërisht versionin e ri me dy vende J-20S.

Kjo strategji po ndiqet edhe nga Britania, Italia dhe Japonia përmes Programit Global të Ajrit Luftarak, që bashkon projektet “Tempest” dhe F-X. Ndërkohë, Franca, Gjermania dhe Spanja po punojnë së bashku në Sistemin e Ajrit të Luftimit të Ardhshëm, një iniciativë që synon të krijojë një “sistem sistemesh” të avancuar për të garantuar superioritetin ajror të Evropës pas vitit 2040. Ky sistem përfshin një avion luftarak të gjeneratës së gjashtë që do të operojë

në çift me mjete ajrore pa pilot, të njohura si transportues të largët.

Rusia, ndonëse nuk ka prezantuar zyrtarisht një program për avionë të gjeneratës së gjashtë, po zhvillon një dron luftarak të rëndë të quajtur Okhotnik, i cili është projektuar për të fluturuar në koordinim me avionin e saj të gjeneratës së pestë Su-57.

Sipas ekspertës Kateryna Bondar, bashkëpunimi mes platformave me dhe pa pilot është një investim i vlefshëm, pasi “kombinon më të mirën e të dy botëve: gjykimin njerëzor dhe shpejtësinë e makinës”. Ajo shton se, ndonëse dronët ofrojnë shkallë operacionale, këmbëngulje dhe rrezik të ulët për personelin, ata ende varen nga komandat njerëzore për vendimmarrje strategjike dhe gjykim moral në mjedis të ndërlikuar dhe dinamike luftarake.

Timothy Heath, studiues i lartë në Korporatën RAND, pajtohet me këtë vlerësim dhe thekson disa përparësi të modelit të bashkëpunimit ajror ndaj kontrollit tokësor të dronëve. “Së pari, një avion i pilotuar që ndodhet pranë tufës së dronëve ka një ndërgjegjësim më të mirë për situatën dhe një kuptim më të qartë të hapësirës së betejës, - thotë ai. Së dyti, kjo afërsi zvogëlon ndjeshëm rrezikun e ndërprerjes së komunikimit mes dronëve dhe operatorëve të tyre. Komandat tokësore, që ndodhen larg zonës së operacionit, janë më të ekspozuara ndaj ndërprerjeve të sinjalit për shkak të kushteve atmosferike, bllokimeve elektronike nga armiku apo faktorëve të tjerë”.

Eksperti në pension i pajisjeve të Forcave Ajrore të Ushtrisë Çlirimtare Popullore (PLA), Fu Qianshao, ka deklaruar se është “jorealiste” të mendohet se avionët luftarakë të së ardhmes do të jenë plotësisht pa ekuipazh.

“Në situata të ndërlikuar luftarake, vendimet nuk janë gjithmonë bardh e zi — ekzistojnë zona gri ku gjykimi njerëzor është i pazëvendësueshëm”, - tha Fu. “Makinëritë ende nuk janë në gjendje të marrin vendime të nuancuara në mënyrë të besueshme.”

Kur bëhet fjalë për projektimin e fuqisë detare, aeroplanmbajtëset mbeten të pazëvendësueshme. Edhe pse Kina po zhvillon dronë nënujorë, ajo vazhdon të investojë në anije luftarake të sofistikuara, duke ndërtuar me ritme të shpejta flotën e saj detare. Aeroplanmbajtësja e saj e tretë, “Fujian”, pritet të hyjë në shërbim këtë vit, ndërsa në dhjetor u lançua Tipi 076 — anija e parë sulmuese amfibe e gjeneratës së ardhshme. Të dyja këto anije janë të pajisura me sistemin e avancuar të katapultës elektromagnetike, që përmirëson ndjeshëm kapacitetet e nisjes së avionëve.

Edhe Shtetet e Bashkuara po vazhdojnë investimet në fuqinë detare. USS “Enterprise” (CVN-80), një aeroplanmbajtëse e klasit “Gerald R. Ford”, është në ndërtim e sipër dhe pritet të dorëzohet deri në vitin 2029. Në të njëjtën kohë, Franca po zhvillon aeroplanmbajtësen e saj të re me energji bërthamore, të quajtur PANG (Porte-Avions de Nouvelle Generation), e cila do të zëvendësojë “Charles de Gaulle” deri në fund të viteve 2030.



ATDHI EU

ka nevojë për ju!

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë gjithmonë në shërbim të kombit, sigurisë dhe paqes. Sot, më shumë se kurrë, kërkohet përkushtimi dhe energjia e brezit të ri, që të jemi bashkë në mbrojtje të vlerave dhe sovranitetit tonë.

Bëhu pjesë e Ushtrisë Shqiptare!

- Ndero flamurin kombëtar
- Shërbe me krenari
- Fito aftësi dhe përvojë të vlefshme për jetën

Bashkohu sot dhe kontribuo në të ardhmen e sigurt të Shqipërisë!

Për më shumë informacion vizitoni:

vizitoni: <https://www.mod.gov.al/karriera-2>